REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 52, datë 25.09.2025

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: "VILË INDIVIDUALE ME 2 KATE MBI TOKË DHE NJË KAT NËNTOKË", ME VENDNDODHJE NË GJILEKË, DHËRMI, BASHKIA HIMARË

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit" i ndryshuar, me propozim të zhvillueses Znj. Alda Elmazaj, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: "Vilë individuale me 2 kate mbi tokë dhe një kat nëntokë", me vendndodhje në Gjilekë, Dhërmi, Bashkia Himarë, me zhvillues Znj. Alda Elmazaj.

2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.

3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet kërkuesit vetëm pas:
   a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
   b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Himarë.

4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, për zbatimin e këtij vendimi.

5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

E D I R A M A

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT - KËSHILLI I MINISTRAVE

MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT

BLENDI GONXHJA

ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA

Nënshkruar më datë 10 /02/ 2026